

VENDIM
Nr.652, datë 29.12.1999

PËR DHËNIEN E LEJES SË FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR JOPUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr.7592, datë 21.6.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 28.5.1999, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e lejes për funksionimin e institucionit arsimor jopublik, të nivelit të arsimit të mesëm, Medreseja “Vexhi Buharaja”, në të cilën zhvillohen edhe lëndë fetare. Institucioni ndodhet në lagjen “Mangalem” të qytetit të Beratit.

2.Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës të kontrollojë procesin mësimor dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën arsimore të këtij institucioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta